

**VENDIM**  
**Nr. 47, datë 23.1.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE E TË PROCEDURAVE PËR  
PËRDORIMIN E FONDIT PËR BLERJEN E NJË PASURIE TË PALUAJTSHME  
QË DO TË SHËRBEJË SI SELI E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
NË LONDËR, MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE E  
IRLANDËS SË VERIUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 13, të nenit 11, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në vijim “Ministria”, dhe Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Londër, në vijim “Ambasada”, realizojnë procedurën e blerjes së një pasurie të paluajtshme në Londër, Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe e Irlandës së Veriut, e cila do të shërbejë si seli e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Londër, me një fond limit jo më shumë se 520 000 000 (pesëqind e njëzet milionë) lekë, sipas rregullave dhe procedurave, të parashikuara në këtë vendim.

2. Kreu i misionit identifikon pasuritë e paluajtshme, të llojit “ndërtesë” dhe “truall”, të cilat kanë hapësirën e nevojshme për ushtrimin funksional dhe në perspektivë të aktivitetit diplomatik e konsullor, vendndodhjen dhe distancën e përshtatshme nga institucionet qendrore të shtetit pritës dhe garantojnë sigurinë fizike, kanë status të lirë nga çdo ngarkesë apo barrë hipotekore, si dhe nuk kanë kufizime juridike me natyrë përmbartimore dhe gjyqësore, dhe propozon jo më pak se 3 (tri) oferta pranë Komisionit, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

3. Për vlerësimin e ofertave ngrihet një Komision i Posaçëm, i kryesuar nga zëvendësministri përgjegjës për punët e jashtme, në përbërje të të cilit ka përfaqësues në nivel drejtues nga:

- a) Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit;
- b) Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare;
- c) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar;
- ç) Avokatura e Shtetit.

4. Komisioni ka këto detyra kryesore:

a) Shqyrton ofertat e paraqitura për blerjen pasurisë së paluajtshme, të propozuara, duke vlerësuar plotësimin e kushteve të përgjithshme, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, si dhe kostot financiare të ofertave të propozuara;

b) Mbikëqyr kreun e misionit në procesin e negociatave për blerjen e pasurisë së paluajtshme dhe lidhjen e kontratës së shitblerjes;

c) Sipas nevojës, vlerëson në terren gjatë procesit të negociatave përmbushjen e kushteve të përgjithshme, sipas pikës 2, të këtij vendimi;

ç) Vlerëson kushtet e projektkontratës së shitblerjes së negociuar;

d) Vendosi shpalljen e ofertës fituese ose skualifikimin e ofertave, sipas rastit.

5. Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave, Komisioni i paraqet ministrit një relacion përmbledhës për procedurën e ndjekur dhe vendimmarrjen e tij.

6. Në rastin kur Komisioni ka shpallur një ofertë fituese, ministri autorizon kreun e misionit për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

7. Pranë ministrisë ngrihet një sekretariat teknik *ad hoc*, i cili ka këto detyra:

- a) Asiston Komisionin në mbarëvajtjen e aktivitetit të tij;

- b) Organizon takimet e Komisionit;
  - c) Administron dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor për procedurën e blerjes.
8. Pas nënshkrimit të kontratës, ministria autorizon Ambasadën që të kryejë pagesat për blerjen e pasurisë së paluajtshme, sipas detyrimeve kontraktore dhe për mbulimin e tarifave shoqëruese që lidhen me finalizimin e procedurës së blerjes.
9. Pas nënshkrimit të kontratës, kreu i misionit merr të gjitha masat për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, sipas legjislacionit të shtetit pritës.
10. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i ministrisë për vitin 2025.
11. Institucionet, sipas pikës 3, të këtij vendimi, caktojnë përfaqësuesit në Komision, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Avokatura e Shtetit dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**